



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:067244
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05427595

E.nr.541/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përbarimit të kreditorit H.T. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Spitali i përgjithshëm në Ferizaj, për pagesën e pagave jubilarë dhe shpenzimet e procedurës, më datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën E.nr.541/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.541/23, të datës 22/03/2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm - Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.895/20, të datës 26.04.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 15.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,334.86euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorë.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.541/23, më datë 08.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi